



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 nëntor 2015
Nr. ref.: RK 855/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI53/15

Parashtrues

Heset Neziri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml.
Nr. 223/2014, të 26 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Heset Neziri nga fshati Burnik, komuna e Ferizajt, të cilin e përfaqëson z. Bahtir Troshupa, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. Nr. 223/2014, i 26 nëntorit 2014, nëpërmjet të cilit kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. Nr. 63/2014, të 19 marsit 2014) dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, (PKR 6/2013, të 3 tetorit 2013) ishte refuzuar si e pabazuar.
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 24 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesi pretendon, se i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI53/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI53/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 10 qershor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 10 qershor 2015, Gjykata i dërgoi një kërkesë Gjykatës Themelore në Ferizaj që të dorëzojë një kopje të fletëkthesës, që tregon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Nr. 223/2014 të 26 nëntorit 2014.

10. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI53/15 për zëvendësimin e gjyqtarit raportues, caktoi Bekim Sejdiun gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin KSH. KI53/15 për zëvendësimin e anëtarit në Kolegjin shqyrtues, caktoi gjyqtarin Altay Suroy anëtar të Kolegjit shqyrtues.
11. Më 9 korrik 2015, Gjykata Themelore në Ferizaj i dorëzoi Gjykatës kopjen e fletëkthesës, e cila tregon se parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 223/2014, më 24 dhjetor 2014.
12. Më 11 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 10 tetor 2011, Prokuroria e Qarkut në Prishtinë kundër parashtruesit të kërkesës ngriti Aktakuzën (PP. Nr. 111-7/2010) për kryerjen e veprës penale, vrasje e rëndë të paraparë me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 9, dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve të paraparë me nenin 328, paragrafi 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK).
14. Më 19 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi, KA. Nr. 687/2011) e vërtetoi aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës dhe filloi shqyrtimin gjyqësor. Si rrjedhojë e riorganizimit të gjykatave, lënda u dërgua më tej për shqyrtim në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda.
15. Më 3 tetor 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda pas shqyrtimit gjyqësor, nxori Aktgjykimin, PKR. Nr. 6/13, me të cilin parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor, për veprën penale pjesëmarrje në rrahje të paraparë me nenin 155, paragrafi 1 i KPPK-së, dhe e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
16. Gjykata Themelore lidhur me vendimin e saj, për shpalljen fajtor të parashtruesit për veprën penale pjesëmarrje në rrahje, vlerësoi si në vijim:

[...]

[Gjykata] analizoi, po ashtu dëshmitë e dëshmitarëve [...] në tërësi dhe në drejtim të këtyre të akuzuarve, vlerësoi mbrojtjet e të akuzuarve, provat materiale dhe duke çmuar të gjitha këto prova në një ndërlidhje njëra me tjetrën erdhi deri te përfundimi konkret i cekur si në dispozitiv të aktakuzës që kanë të bëjnë me të akuzuarin Heset Neziri [...].

17. Parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit, PKR. Nr. 6/13 të Gjykatës Themelore në Ferizaj ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të Ligjit penal, dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.
18. Përkitazi me pretendimin për vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike, në ankesën e tij, parashtruesi ndër të tjera pohoi, se Gjykata Themelore kishte refuzuar

kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitares së tij, gjegjësisht bashkëshortes së tij për të vërtetuar alibinë e tij në ditën e ngjarjes dhe po ashtu pohoi se atij i ishte mohuar e drejta që gjatë procesit gjyqësor të vazhdojë të marrë në pyetje dëshmitarin kryesor të rastit, njëherazi edhe palën e dëmtuar.

19. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Ferizaj, ankesë kishte parashtruar edhe Prokurori Themelor në Ferizaj, me pretendimin për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Prokurori Themelor në Ferizaj në ankesën e tij kishte kërkuar që Gjykata e Apelit të ndryshojë Aktgjykimin dhe parashtruesin e kërkesës ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale, vrasje e rëndë, të paraparë me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 9, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve të paraparë me nenin 328, paragrafi 2 të KPPK-së.
20. Më 19 mars 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, PAKR. Nr. 63/2014) refuzoi ankesat e parashtruesit dhe të Prokurorit Themelor në Ferizaj si të pa bazuara, dhe vërtetoi Aktgjykimin, PKR. Nr. 6/13 të Gjykatës Themelore në Ferizaj të 3 tetorit 2013. Gjykata e Apelit gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.
21. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore në Ferizaj kishte refuzuar kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitarit të tij, Gjykata e Apelit konstatoi se *"[...]dëshmitë e palëve të dëmtuara i rrëzojnë këto pretendime [...], të cilët ndër të tjera kanë deklaruar dhe përshkruar veprimet e tyre e që arsyetimin e dhënë në këtë drejtim nga ana e gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë"*.
22. Ndërsa, sa i përket ankesave të parashtruesit të kërkesës dhe Prokurorit Themelor në Ferizaj lidhur me lartësinë e dënimit, Gjykata e Apelit konstatoi se pretendimet e tyre ankimore ishin të pabazuara. Në lidhje me këtë, Gjykata e Apelit vlerësoi se: *"[...] dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve [...] nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 34 të KPK"*.
23. Më 8 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit (PKR 6/2013, të 3 tetorit 2013) të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Aktgjykimit (PAKR. Nr. 63/2014, të 19 marsit 2014) të Gjykatës së Apelit, me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe Ligjit penal. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera pretendoi se gjykata në mënyrë arbitrare kishte refuzuar propozimin e tij për dëgjimin e bashkëshortes së tij për të vërtetuar alibinë e tij për mosprezencë në vendin e ngjarjes, dhe i kishte mohuar të drejtën për vazhdimin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve kryesorë, njëherazi edhe palë të dëmtuara në procedurë.
24. Më 17 nëntor 2014, Prokurori i Shtetit (Parashtresa KMLP II, Nr. 164/2014) propozoi që kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet.

25. Më 26 nëntor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi, Pml. Nr. 223/2014) e refuzoi, si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës.
26. Përkitazi me pretendimin e lartcekur të parashtruesit për refuzimin e kërkesës së tij për dëgjimin e bashkëshortes së tij, në cilësi të dëshmitares, Gjykata Supreme konstatoi se:

“[...] lidhur me propozimin e refuzuar që në cilësi të dëshmitares të dëgjohej bashkëshortja e të denuarit janë dhënë arsye edhe në aktgjykimet e kundërshtuara, meqë në provat e administruara është vërtetuar kryerja e veprës penale nga i dënuari i cili për një periudhë kohore edhe ka qenë në arrati.

[...]

[]... arsyet e theksuara janë vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë e cila ka gjetur se provat e administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë reflektojnë vlerësim të drejtë të provave dhe si të tilla edhe Gjykata Supreme i aprovon si të drejta dhe të ligjshme, për çka kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e refuzon si të pabazuar”.

27. Si përfundim, Gjykata vërtetoi se pretendimet e parashtruesit të vlerësuara nga Gjykata e Apelit dhe provat e administruara nga Gjykata e shkallës së parë reflektojnë vlerësim të drejtë të provave, dhe po ashtu, konstatoi se pretendimet e parashtruesit *“[...] përkitazi me shkeljen e Ligjit penal janë të paqarta, për faktin se shkeljet e Ligjit Penal për të cilat mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të përshkruara me dispozitën e nenit 385 e cila dispozitë ligjore në mënyrë taksative parasheh rastet se kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është përfshirë në këto shkelje”.*

Pretendimet e parashtruesit

28. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi në kërkesën e tij pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, si dhe nenit 10 të DUDNJ-së.
29. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykata i ka refuzuar propozimet e tij për të dëgjuar si dëshmitar bashkëshorten e tij dhe i është mohuar e drejta që të marrë në pyetje dëshmitarin kryesor.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të :

“Shpall të pranueshëm kërkesën e parashtruesit Heset Neziri, Shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. Nr. 223/2014, të 26 nëntorit 2014 . Të kthej në shqyrtim Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. Nr. 223/2014, të 26 nëntorit 2014”.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

33. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

34. Ashtu siç u cek më lart, në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për arsye se Gjykata i ka refuzuar propozimin e tij për të dëgjuar si dëshmitar bashkëshorten e tij dhe se atij i është mohuar e drejta që të vazhdojë marrjen në pyetje të dëshmitarit kryesor.

35. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit kishte vlerësuar se dëshmitë e palëve të dëmtuara i rrëzojnë pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, dhe si rrjedhojë, e kishte vërtetuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

36. Në vijim, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj kishte vërtetuar se bazuar në administrimin e provave nga gjykata e shkallës së parë dhe arsyetimet e dhëna në aktgjykimet e kundërshtuara, ishte vërtetuar kryerja e veprës penale nga parashtruesi i kërkesës. Ndërsa, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitar kryesor, Gjykata Supreme konstatoi se në bazë të procesverbalit të

shqyrtimit gjyqësor, rezulton se procesi gjyqësor ishte zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore.

37. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me vlerësimin e fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale dhe ligjore nga gjykatat e rregullta. Vlerësimi i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.
38. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
39. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
40. Gjykata vëren se në kërkesën e tij parashtruesi nuk ofron argumente të qëndrueshme, përkatësisht nuk dëshmon se si i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurave të përfunduara në gjykatat e rregullta nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezótúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih Rastin KI198/13, parashtrues i kërkesës *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).
42. Përveç kësaj, siç u cek më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjeti se procedurat në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe në Gjykatën e Apelit nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
43. Në fund, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të së drejtës së tij të garantuar me Kushtetutë (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).
44. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të

së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

45. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1), d) dhe (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi